

VENDIM

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka depozituar më 06.04.2023 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për procedim disiplinor me masën “Ulja e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit” ndaj magjistratit B.M. dhe me masën “Vërejtje publike” ndaj magjistratit R.A., të dy gjyqtarë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare të dt.12.03.2025 me vendimin nr.150, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratëve B.M. dhe R.A. pa një vendim përfundimtar.